VENDIM
Nr. 320, datë 12.12.2025

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "GREEN ENERGY" SHPK PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E ASETEVE FIKSE TË SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të neneve 16, 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, germa "b", të "Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2934/2 prot., datë 4.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Green Energy' sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve",

konstatoi se,

- Shoqëria "Green Energy" sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 121, datë 9.6.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet 2 mw, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.
- Me shkresat nr. 2934 prot., datë 26.11.2025 dhe nr. 2934/1 prot., datë 27.11.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE, për vendosjen e aseteve të saj si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj Bankës Amerikane të Investimeve sh.a.
- Në kuadër të kësaj kërkese dhe në mbështetje të dispozitave të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", shoqëria ka depozituar kontratat e kredive, si dhe informacion mbi vlerën e aseteve të projektit, nga e cila rezulton se vlera e tyre është më e vogël se 150.000.000 lekë.
- Në nenin 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, përcaktohet se, miratimi i ERE-s nuk është i nevojshëm në rastet e transferimit të aseteve me vlerë minimale, apo aseteve që nuk lidhen ngushtësisht me veprimtarinë e licencuar, sipas rregullores së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, sikurse cituar dhe më sipër në këtë relacion, ky parashikim ligjor është konkretizuar në nenin 4, germa "b", të "Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", ku përcaktohet se, për transferimin e aseteve të të licencuarve me kapacitet të instaluar nën 1 mw, nuk ka nevojë për miratimin e ERE-s. Për të gjithë të licencuarit e tjerë do të kërkohet miratimi i ERE-s për transferim të aseteve kur vlera e asetit që kërkohet të transferohet është më e madhe se 150.000.000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë.
- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet se ERE nuk mund të marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "Green Energy" sh.p.k., për sa kohë nuk plotësohet sa kërkuar në nenin 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 dhe nenin 4, germa "b", të rregullores me nr. 119/2016.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "Green Energy" sh.p.k. për dhënien e autorizimi nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të shoqërisë, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj Bankës Amerikane të Investimeve sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Green Energy" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti